



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 22 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21 / 02 / 2024

VENDIM

Nr. 05 date 21 / 02 / 2024

PËR

PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT

“RIKONSTRUKSIONI I NYJES HIDROTEKNIKE TË MANSKURISË”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.02.2024 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e paraqitur nga UK Durrës për Rikonstruksionin e nyjes hidroteknike të Manskurisë e cila administrohet nga UK Durrës. Diga e Manskurisë me lartësi 36 m është ndërtuar në vitin 1969.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente Zenit&CO shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se **projekti nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 5, pika B të ligjit të mësipërm si dhe të nenit 8 të VKM së mësipërme.** Relacioni hidrologjik dhe relacioni me karakteristikat e materialeve të ndërtimit mungojnë në dokumentacionin e paraqitur. Kërkesat e KKDM të dhëna në Vendimin e KKDM Nr. 15, datë 25.05.2023 nuk janë plotësuar. Konkretisht, në dokumentacionin e dorëzuar mungojnë llogaritjet dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së digës në kushtet aktuale dhe pas rehabilitimit të parashikuar, Raportin teknik për sistemet e monitorimit që duhet të instalohen në digë dhe sistemin e Alarmit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, kurba e volumeve dhe sipërfaqeve aktuale të ujit për rezervuarin e Manskurisë bazuar në matje faktike batimetrike. Studimi Sizmik nuk plotëson kërkesat e KKDM në lidhje me rrezikun sizmik për digat.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mungon detyra e projektimit, raporti dhe llogaritjet për verifikimin e qëndrueshmërisë së digës, rezultatet për matjet batimetrike të volumit të ujit në rezervuar, raporti për sistemet e monitorimit në digë, raporti i një studio këshillimi me licencë dhe eksperiencë në fushën e projektimit të digave, etj

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antareve të KKDM të mos miratoj Projekt zbatimin e paraqitur për shkak të mungesave të paraqitura me sipër dhe mosplotësimin të kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

- 1- **Të mos miratoj Projekt Zbatimin për Rikonstruksionin e Nyjes Hidroteknike në Rezervuarin e Manskurisë për shkak të mangësive të konstatuara në dokumentacionin teknik të paraqitur si dhe mosplotësimin të kërkesave të legjislacionit në fuqi.**
- 2- **Ti kërkoj Shoqërisë Rajonale të UK Durrës**
 - Të plotësoj dokumentacionin teknik të projektit me detyren e projektimit, relacionin e plotë hidrologjik, relacionin me karakteristikat e materialeve të ndërtimit, relacionin dhe llogaritjet përkatëse për verifikimin e qëndrueshmërisë së digës para dhe pas rikonstruksionit, relacionin në lidhje me sistemet e monitorimit që duhet të instalohen në digë, relacionin në lidhje me instalimin e sistemit të alarmit në digë dhe në zonën urbane poshtë saj, raportin e firmës këshilluese të licencuar dhe me eksperiencë në fushën e digave, relacion në lidhje me rregulloren e shfrytëzimit dhe monitorimit të digës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Të rishikoj raportin në lidhje me gjëndjen e digës, problematikat e konstatuara në të si dhe masat që duhet të merren për zgjidhjen e tyre.
- Të rishikoj studimet mbështetëse për Gjeoteknikën dhe Sizmikën e zonës në përputhje me kushtet aktuale dhe udhëzimeve të KKDM të shprehura në Vendimin Nr. 15, datë 15.02.2021.
- Të kryeje matjet batimetrike për volumet dhe sipërfaqet e ujit në rezervuar dhe në bazë të këtyre matjeve të pregatit kurbat e volumeve dhe sipërfaqeve të ujit në rezervuarin e Manskurisë si dhe një relacion në lidhje me procesin e sedimentimit në rezervuar.
- Të kryejë kontrollin e kapacitetit përcjellës të shkarkuesit katastrofik në funksion të rriskut të lartë për zonën urbane poshtë kësaj dige në rast të prishjes së saj apo prurjeve maksimale të ujit sipas kërkesave të Vendimit të KKDM Nr. 36, datë 25.10.2023
- Të plotësoj dokumentacionin e projektit të zbatimit për rikonstruksionin e nyjes hidroteknike të rrezvuarit të Manskurisë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë e digës dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të zbatimit të këtyre punimeve, të qartësoj dhe të shprehet në lidhje me domosdoshmërinë dhe efektivitetin e zbatimit të punimeve për rikonstruksionin e kësaj dige.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

